

DEKLARATË

Një model i qëllimshëm pengesash nga 2A Group dhe VIA po rrezikon seriozisht përfundimin në kohë të Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës, me heshtjen e plotë të MIE

Lugano, 10 Prill 2026

Shoqëria zvicerane MABCO Constructions SA, aksionari shumicë (98%) dhe investitori kryesor dhe garant financiar i projektit të Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës, denoncon publikisht një model të qëllimshëm dhe të vazhdueshëm pengesash, sabotimi operacional dhe ndërhyrjesh të paligjshme të ndërmarra nga administratori i ashtuquajtur i VIA sh.p.k., z. Vegim Hoxha, nën drejtimin dhe në shërbim të interesave të aksionarit minoritar 2A Group (Valon Ademi, 2%). Ky model, i dokumentuar gjerësisht që nga uzurpimi i paautorizuar i administrimit të VIA-s në dhjetor 2025, ka kulmuar gjatë ditëve të fundit në veprime që rrezikojnë drejtpërdrejt certifikimin, operimin dhe integritetin teknik të aeroportit.

MABCO thekson me shqetësim të thellë se të gjitha këto zhvillime janë ndodhur nën sytë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), e cila, pavarësisht njoftimeve të shumta dhe thirrjeve të përsëritura për ndërhyrje institucionale, ka zgjedhur heshtjen dhe pasivitetin e plotë. Ky qëndrim nuk është vetëm shqetësues; ai është i papranueshëm dhe e bën MIE-n bashkëpërgjegjëse de facto për pasojat e kësaj situatë.

1) Modeli i pengesave: Nga uzurpimi i administrimit tek sabotimi operacional

Që nga momenti kur 2A Group (me vetëm 2% të kapitalit) ka uzurpuar kontrollin e VIA-s nëpërmjet një mbledhjeje të paligjshme asamblejeje (11 dhjetor 2025, pa njoftuar dhe pa praninë e aksionarit shumicë 98%) dhe ka regjistruar Vegim Hoxhën si administrator në kundërshtim me ligjin dhe statutin, modeli i veprimeve ka qenë i qëndrueshëm dhe sistematik:

- Bllokimi i aksesit të stafit teknik dhe drejtuesve të MABCO-s në kantier, nëpërmjet kërkesash të paligjshme për të dhëna personale dhe procedurash autorizimi pa bazë ligjore.
- Pengimi i delegacionit ndërkombëtar të DAA Dublin (i angazhuar nga MABCO për certifikimin e aeroportit dhe njoftuar paraprakisht tek MIE) nga aksesit në kantier.
- Refuzimi i pajustificuar i pagesave të detyrimeve doganore për mjetet zjarrfikëse dhe pajisjet e sigurisë aeroportuale, duke i lënë ato të bllokuara në doganë dhe duke rrezikuar konfiskimin e tyre, megjithëse fondet ishin të disponueshme në llogarinë e VIA-s.
- Ndërhyrja e paligjshme dhe sabotimi i marrëdhënieve kontraktore me operatorin ndërkombëtar DAA International dhe Airport Excellence GmbH, duke dërguar komunikime formale që mohojnë kontratën e lidhur nga MABCO dhe kërkojnë trajtim ekskluziv me VIA-n nën kontrollin e 2A Group.

- Pengimi i auditit teknik të pavarur të pistës dhe godinat kritike të aeroportit, i kërkuar nga MABCO që nga shtatori 2025 dhe refuzuar sistematikisht, pavarësisht gatishmërisë së MABCO-s të mbulojë të gjitha kostot.
- Transferimi i përgjegjësisë kontraktuale për të ndërtuar sistemet e ndriçimit të pistës AGL nga 2A Group tek MABCO pa miratim asamblejeje, dhe pastaj pengimi i ekzekutimit të punimeve për këtë qëllim.
- Dërgimi i paralajmërimeve me shkrim nga Vegim hoxha për ndërprerjen e kontratës së punimeve të VIA-s me MABCO-n, model ky i qartë i një strategjie eliminimi të investitorit kryesor.

2) Incidenti i fundit 8 Prillit 2026: Ndërhyrje me forcë policore kundër punimeve AGL

Më datë 8 Prill 2026, ky model ka arritur kulmin e tij: kompanitë e specializuara ndërkombëtare AVIATOR Beacon LLC dhe BOSCH, të angazhuara nga MABCO për instalimin e sistemeve AGL (ndriçimi i pistës), janë ndaluar fizikisht nga hyrja në kantier nga Vegim Hoxha dhe 2A Group. Përfaqësuesi ligjor i MABCO-s, Av. Ili Gërdupi, Drejtori Teknik Naser Gjuka dhe Inxhinieri Arbër Mihola u morën në pyetje nga policia, sipas një kallëzimi të bërë nga Mentor Qafleshi, përfaqësues i 2A Group, i cili ka pretenduar se punimet AGL dëmtojnë pistën, pretendim ky absurd dhe i rremë, i kundërshtuar nga deklaratat teknike të OCEM, Aviator dhe FMC Engineering.

Vegim Hoxha, nëpërmjet letrave zyrtare (protokoll Nr. 034, datë 8 Prill 2026), ka lëshuar urdhër për largimin e menjëhershëm dhe ndalimin e aksesit të gjithë stafit dhe nënkontraktorëve të MABCO-s nga kantier (përfshirë kompani me reputacion global si BOSCH dhe AVIATOR) dhe ka paralajmëruar zgjidhjen e kontratës. Ky veprim, i ndërmarrë kundër aksionerit shumicë, përbën shkelje flagrante kontraktuale dhe ndërhyrje të paligjshme në procesin e certifikimit.

Punimet AGL ndodhen aktualisht në fazën e instalimit të trupave ndriçues inset, ku 35-45% e punimeve janë realizuar. Ndërprerja e tyre krijon rrezik real për dëmtime të riparueshme në pistë (RWY) dhe shënon pasoja të drejtpërdrejta në afatet kontraktuale dhe certifikimin ndërkombëtar CAT II/III.

3) Çështjet teknike dhe ndërhyrjet korrigjuese të MABCO-s

MABCO ka identifikuar devijime të rëndësishme në parametrat e ndërtimit të pistës (e cila është krejtësisht nën përgjegjësinë kontraktuale të 2A Group), përfshirë një diferencë prej rreth 10 cm nën kuotën e projektua. Ky element ndikon drejtpërdrejt në standardet e sigurisë dhe certifikimit si dhe projektin teknik të AGL. Për të adresuar këtë problematikë, me burimet e veta dhe pa ngarkuar VIA-n, MABCO ka ridizajnuar plotësisht sistemin AGL në bashkëpunim me ekspertë ndërkombëtarë të specializuar (FMC Engineering, Aviator Beacon), për të garantuar përputhshmëri të plotë me standardet ndërkombëtare. Pikërisht kur kjo fazë kritike po ekzekutohej, konkretisht në fazën e instalimit të ndriçimit, Vegim Hoxha dhe 2A Group kanë zgjedhur të ndërhyjnë me forcë.

4) Pasiviteti i papranueshëm i MIE — Autoriteti Kontraktues

MABCO ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) rregullisht dhe transparentisht gjatë të gjithë kësaj periudhe për këto ngjarje dhe nuk ka marrë as përgjigje dhe as ndërhyrje konkrete. Heshtja e MIE-s përballë këtyre zhvillimeve nuk është thjesht mungesë reagimi; ajo është vendim de facto për të toleruar sabotimin e një projekti të interesit publik strategjik kombëtar nga një aksionar minoritar me 2% të kapitalit, i cili vepron kundër interesit të shoqërisë dhe kundër aksionarit shumicë. MIE, si Autoritet Kontraktues sipas Kontratës së Koncesionit, ka detyrime ligjore dhe kontraktuale të qarta për të ndërhyrë. Mospërbushja e tyre e ekspozon institucionin ndaj përgjegjësisë institucionale dhe kontraktuale të plotë.

5) Qëndrimi i MABCO-s

MABCO Constructions SA riafirmon qartë dhe pa ekuivok:

- Mbetet e angazhuar për përfundimin me sukses të projektit të Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës, si partner i vetëm strategjik me kapacitet financiar, teknik dhe operacional të vërtetuar.
- Kërkon ndërhyrjen e menjëhershme dhe konkrete të MIE-s për garantimin e aksesit të plotë të MABCO-s dhe nënkontraktorëve të saj në kantier dhe rifillimin e menjëhershëm të punimeve AGL.
- Paralajmëron se çdo vonesë shtesë do të konsiderohet si shkelje e rëndë kontraktuale e VIA-s dhe do të gjenerojë përgjegjësi të plotë kontraktuale, civile, administrative dhe penale, duke përfshirë pretendime nën Traktatin e Investimeve Zvicëri–Shqipëri.
- Do të bëjë publike të gjithë dokumentacionin e nevojshëm që dëshmon modelin e qëllimshëm të pengesave të 2A Group dhe Vegim Hoxhës, si dhe pasivitetin institucional të MIE-s.

MABCO rezervon të gjitha të drejtat e saj ligjore dhe kontraktuale dhe do të ndërmarrë pa hezitim të gjitha veprimet e nevojshme për mbrojtjen e investimit të saj dhe të interesit publik të projektit të Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës.

Për informacion:

MABCO Constructions SA

Via Cattori 7, 6902 Lugano-Paradiso, Zvicër

Znj. Ornella Çuçi

Corporate Communications Office

press@mabetex.com